**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria-Vlada-Government*
**Ministria e Ekonomisë**
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**

# RAPORTI I PROGRESIT PËR VITET 2022 - 2023

# I

# PROGRAMIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË ENERGJISË SË KOSOVSËS (PZSEK) PËR PERIUDHËN 2022-2025

**Prishtinë, prill 2024**

# Përmbajtja

1 Shkurtesat: ........ 3
2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE ........ 4
3 PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE ........ 7
4 PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT ........ 7
5 RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE ........ 10
6 SHTOJCA- MATRICA E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITET 2022-2023 **Error! Bookmark not defined.**

# 1 Shkurtesat:

| | |
|---|---|
| BE | Bashkimi Evropian |
| BRE | Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë |
| BRE-E | Energjia elektrike e prodhuar nga burimet e ripërtëritshme |
| CERT | Ekipi i komunitetit për reagim urgjent |
| $CO_2$ | Dioksidi i Karbonit |
| EE | Efiçienca e Energjisë |
| ESCO | Kompania e Shërbimit të Energjisë |
| VNMS | Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social |
| PZSE | Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë |
| FKEE | Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë |
| GS | Gazrat Serë |
| IPF9 | Objekti i Projektit të Infrastrukturës - Asistencë Teknike 9 |
| KEDS | Kompania Kosovare e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike |
| KEK | Korporata Energjetike e Kosovës |
| KfW | Instituti i Kredive për Rindërtim |
| KOSTT | Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës |
| Ktoe | Kilo ton ekuivalent nafte |
| MAShT | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit |
| MCAK | Llogaria e Sfidës së Mijëvjeçarit-Kosovë |
| MCC | Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit |
| ME | Ministria e Ekonomisë |
| MFK | Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë |
| MFPT | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| MMPHI | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| MW | Mega Wat |
| MWt | Mega Wat termik |
| NOx | Oksidet e Azotit |
| NQ | Ngrohja Qendrore |
| OSSh | Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes |
| OST | Operatorët e Sistemit të Transmetimit |
| SAIDI | Indeksi Mesatar i Kohëzgjatjes së Ndërprerjes së Sistemit |
| SAIFI | Indeksi i Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve të Sistemit |
| SCADA | Kontrolli Mbikëqyrës dhe Marrja e të Dhënave |
| $SO_2$ | Dioksidi i Sulfurit |
| ETS BE | Sistemi i Tregtimit të Emetimeve të Bashkimit Evropian |
| WBIF | Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor |
| ZRrE | Zyra e Rregullatorit për Energji |

# 2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ministria e Ekonomisë (ME), ka hartuar Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK), për periudhën 2022-2025, i cili është miratuar më 5 shtator të vitit 2023 në Qeverinë e Republikës së Kosovës (QRK).

Bazuar në nenin 7 pika 7 e Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, Ministria e Ekonomisë (ME), ka obligim ligjor që të bëjë monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës. Prandaj ministria ka hartuar Raportin Vjetor për vitet 2022 - 2023, mbi progresin e realizimit të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës për periudhën 2022-2025, si dhe nivelin e zbatimit të Strategjisë së Energjisë për periudhën 2022-2031 i cili është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.

Raporti i Progresit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për vitet 2022 - 2023 është hartuar bazuar në Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025 dhe janë paraqitur aktivitetet e detajuara për zbatimin e objektivave të parashikuara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031.

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025, përfshin një listë prej pesë (5) objektivash strategjike, pesëmbëdhjetë (15) objektivash specifike dhe nëntëdhjetë (90) aktiviteteve që parashihen të realizohen për zhvillimin e sektorit te energjisë.

Raporti i progresit ka për qëllim që të evidentoj shkallën e zbatimit të projekteve të paraqitura në Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për vitet 2022 - 2023, si dhe të evidentohen sfidat dhe të propozohen rekomandimet për vendimmarrje nga autoritetet përkatëse.

Në raport të progresit janë përfshirë të gjitha projektet dhe aktivitetet që kanë filluar para apo gjatë viteve 2022- 2023 dhe që vazhdojnë edhe gjatë viteve të ardhshme, po ashtu edhe projektet dhe aktivitetet të cilat fillojnë dhe përfundojnë në vitet 2022 - 2023.

Objektivat strategjike janë:

Objektivi 1: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit;
Objektivi 2: Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme;
Objektivi 3: Rritja e Efiçiencës së Energjisë (EE);
Objektivi 4: Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut;
Objektivi 5: Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve.

**Në vitin 2022 si arritje mund të vlerësohen**:

Investimi në rrjetin e distribucionit ku është arritur përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike, dhe reduktimi i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Instalimi i njehsorëve të energjisë elektrike, është një arritje tjetër nëpërmjet të cilit është rritur saktësia në matje, matje në distancë, faturim dhe lexim i saktë dhe i shpejt.

Investimi në Teknologji Informative (TI)- Nga ky investim do të arrihet mbrojtja e të dhënave, siguria kibernetike, thjeshtimi i strukturës së të dhënave të kompanisë dhe rritja e produktivitetit. Të gjitha këto investime ndikojnë në përmirësimin e besueshmërisë së sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës.

Si arritje tjetër e një rëndësie të veçantë është edhe zbatimi i masave të Efiçencës së Energjisë (EE). Me zbatimin e masave të Efiçiencës së Energjisë (EE), në ndërtesa publike (në nivel komunal), është arritur kursim i energjisë elektrike në vlerë 0.78 ktoe/vit. Përveç sektorit publik, zbatim të masave të Efiçiencës së Energjisë (EE), ka pasur edhe në sektorin rezidencial (njëzet e gjashtë (26) ndërtesa shumë banesore), dhe përmes këtij investimit sipas një vlerësimi paraprak pritet të arrihet kursim i energjisë elektrike deri në tridhjet përqind (30%).

Sektor tjetër që cilësohet që ka pasur progres në realizimin e aktiviteteve është sektori i ngrohjes. Me investimet në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të Ngrohjes Qendrore (NQ) në Prishtinë. Gjithsej janë rehabilituar, zgjeruar dhe densifikuar 17,834m gyp i rrjetit të “Termokosit”. Instalimi i pajisjeve matëse për konsumatorët e “Termokosit”, është përmirësuar sistemi i Ngrohjes Qendrore ( NQ) në Prishtinë.
Investime ka pasur edhe në Ngrohtoren e Qytetit të Gjakovës, në instalimin e orëmatësve dhe në rehabilitimin e treqind e pesëdhjetë e pesë (355) nënstacioneve.

Për mbështetjen e konsumatorëve në nevojë, dhe konsumatorëve të tjerë është realizuar subvencionimi i familjeve të cenueshme dhe subvencionimi i faturave të energjisë elektrike.

**Në vitin 2023 si arritje mund të vlerësohen**:

Investimi në rrjetin e tensionit të mesëm dhe rrjetin e tensionit të ulët, përfshinë projektet për përforcimin të rrjetit dhe shndërrimin e rrjetit nga 10kV në 20kV. Me këtë investim është arritur përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike, dhe reduktimi i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Investimet në instalimin e njehsorëve cilësohet si një arritje tjetër nëpërmjet të cilit është arritur saktësi në matje, matje në distancë, faturim dhe lexim i saktë dhe i shpejt. Investim ka pasur edhe në Teknologji Informative (TI), të rrjetit të shpërndarjes, ku nga ky investim do të arrihet mbrojtja e të dhënave, siguria kibernetike, thjeshtimi i strukturës së të dhënave të kompanisë, dhe rritja e produktivitetit. Të gjitha këto investime ndikojnë në përmirësimin e besueshmërisë së sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës.
Si arritje tjetër e një rëndësie të veçantë është edhe zbatimi i masave të Efiçencës së Energjisë (EE). Me zbatimin e masave të Efiçiencës së Energjisë (EE), në ndërtesa publike (në nivel komunal) është arritur kursim i energjisë elektrike në vlerë 1.67 ktoe /vit.

Për mbështetjen e konsumatorëve në nevojë dhe konsumatorëve të tjerë, është realizuar subvencionimi i familjeve të cenueshme dhe subvencionimi i faturave të energjisë elektrike.

Edhe në vitin 2023 ka pasur progres në realizimin e aktiviteteve në sektorin e ngrohjes, kanë vazhduar investimet në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të Ngrohjes Qendrore (NQ) në Prishtinë dhe instalimi i pajisjeve matëse për konsumatorët e “Termokosit” është përmirësuar sistemi i Ngrohjes Qendrore (NQ) në Prishtinë.

Investime ka pasur edhe në Ngrohtoren e Qytetit të Gjakovës në modernizimin dhe digjitalizimin e sistemit të ngrohjes, po ashtu edhe kyçje të reja të ndërtesave publike.

Si arritje tjetër për vitin 2023 mund të konsiderohet edhe krijimi i infrastrukturës ligjore përmes miratimit të disa akteve nënligjore si: Udhëzimi Administrativ Nr.01/2023 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme; Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2023 për Cakun e Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE); Legjislacioni sekondar për prosumatorë.

Arritja e realizimit të objektivave për vitin 2022 ka qenë shtatëdhjetë e tre pikë shtatë përqind (73.7%), kurse për vitin 2023 arritja e objektivave ka qenë pesëdhjetë e një pikë tetë përqind (51.8%).

Në vazhdim janë paraqitur të arriturat e objektivave në formë tabelore dhe grafike për vitet 2022 - 2023.

| | 2022 | 2023 |
|---|---|---|
| **Objektivi 1** | 59.2% | 51.8% |
| **Objektivi 2** | 68.3% | 51.3% |
| **Objektivi 3** | 62.8% | 51.0% |
| **Objektivi 4** | 80.0% | 60.0% |
| **Objektivi 5** | 98.0% | 45.0% |
| **Totali** | **73.7%** | **51.8%** |



# 3 PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Në këtë raport të progresit është paraqitur shkalla zbatimit të aktiviteteve, dhe projekteve të parapara për vitet 2022 - 2023.

Për përgatitjen e këtij raporti, është themeluar Grupi Koordinues (GK) ndërinstitucional, ku ME-ja, ka përgatitur matricën, dhe ju është dërguar të gjithë anëtarëve të grupit që të raportojnë për të arriturat, sfidat dhe problematikat në zbatimin e projekteve të parapara për vitet 2022 - 2023. Pas marrjes se inputeve nga anëtarët e Grupit Koordinues (GK), është bërë edhe me tutje përpunimi i matricës dhe është bërë finalizimi.

Bazuar në të dhënat e plotësuara nga institucionet përgjegjëse në matricën e dërguar është përgatitur pjesa narrative e këtij raporti.

Në pjesën narrative është bërë përshkrimi i progresit të secilit objektiv strategjik, ku përshkruhen të arriturat, arsyeja e vonesave të disa aktiviteteve/projekteve si dhe sfidat për disa projekte të cilat nuk janë realizuar në tërsi.

Përshkrimi i mëposhtëm është bazuar në strukturën e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovë (PZSEK) për periudhën 2022-2025, ku janë të përfshira aktivitete dhe projektet e vitet 2022 - 2023.

# 4 PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT

**<u>Objektivi 1: Përmirësimi i Besueshmërisë së Sistemit</u>**

Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit, përfshin të gjitha aktivitetet që garantojnë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe funksionimin e një sistemi elektroenergjetik stabil.

Në vitin 2022, në zbatim të këtij objektivi, aktivitetet të cilat janë realizuar plotësisht janë ndër treguesit kryesore për arritjen e masave duke konstatuar një realizim mesatar të këtij objektivi. Aktivitetet e parapara dhe të cilat janë realizuar kanë ndikuar në përmirësimin e besueshmërisë së sistemit, kjo është arritur bazuar në këto aktivitete:

- Projektet e tensionit të mesëm 35/10(20) kV;
- Instalimi i njehsorëve;
- Investimet kapitale në Teknologjinë Informative (TI).

Në vitin 2023, aktivitetet të cilat janë realizuar plotësisht, janë ndër treguesit kryesor për arritjen e objektivave specifike duke konstatuar një realizim mesatar të këtij objektivi. Aktivitetet e parapara dhe të cilat janë realizuar kanë ndikuar në përmirësimin e besueshmërisë së sistemit, kjo është arritur bazuar në këto aktivitete:

- Projektet e tensionit të mesëm 35/10(20) kV;
- Instalimi i njehsorëve;
- Investimet kapitale në Teknologjinë Informative (TI);
- Mbështetja e ngarkesës/nyjet e reja110/10 (20) kV(OST&OSSH) (SS Kastriot Ferizaj 3 dhe TS Malisheva), (SS Kastrioti Ferizaj 3 dhe TS Malisheva);
- Miratimi i ligjit për siguri kibernetike;
- Master Plani i Zhvillimit të Gazit dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor;
- Studimi i fizibilitetit për Gazsjellësin e Interkoneksionit të Maqedonisë Veriore-Kosovë.

## Objektivi 2: Dekarbonizimi dhe Promovimi i Energjisë së Ripërtëritshme

Rruga drejt zvogëlimit të emetimeve të dioksidit të karbonit të sektorit do të shoqërohet me zhvillimin e kapaciteteve të mëdha të BRE-ve, bazuar në potencialin teknik dhe ekonomik të tyre.

Shumica e aktiviteteve të parapara kanë të bëjnë me fillimin e hartimit të akteve ligjore, nënligjore, planeve dhe studimeve të fizibilitetit, me qëllim të krijimit të infrastrukturës së përshtatshme për investime.

Në vitin 2022, janë hartuar draftet e para të dokumenteve:

- Ligji për Burime të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE);
- Hartimi i legjislacionit sekondar për prosumatorët;
- Metodologjia e taksës së kyçjes në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSh).

Në vitin 2023, janë hartuar dhe miratuar disa nga aktivitetet e parapara për këtë vit dhe të bartura nga vitin 2022:

- Udhëzimi Administrativ Nr.01/2023 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2023 për Cakun e Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE);
- Legjislacioni sekondar për prosumatorë;
- Metodologjia e taksës së kyçjes në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSh);
- Shpallja e ankandit për kontraktimin e ankandit të parë pilot për 100MW solar.

## Objektivi 3: Rritja e Efiçiencës së Energjisë (EE)

Rritja e Efiçiencës së Energjisë (EE), është thelbësore për të arritur katër (4) caqet e strategjisë së energjisë: ajo përmirëson sigurinë e furnizimit me energji dhe zvogëlon varësin nga importi, zvogëlon barrën e konsumatorëve dhe zvogëlon emetimet e GS-ve dhe ndotjen e ajrit.

Në vitin 2022 numri i aktiviteteve të cilat janë realizuar në këtë vit, janë ndër aktivitetet të cilat kanë ndikuar në rritjen e Efiçiencës së Energjisë (EE), duke konstatuar një realizim të kënaqshëm. Këto aktivitete janë:

- Zbatimi i masave të Efiçiencës së Energjisë (EE), në sektorin rezidencial (njëzet e gjashtë (26) ndërtesa shumë banesore);
- Zbatimi i masave të Efiçiencës së Energjisë (EE) në sektorin rezidencial;
- Zbatimi i masave të Efiçiencës së Energjisë (EE) në ndërtesa publike ( në nivel komunal);
- Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit të Ngrohjes Qendrore (NQ) në Prishtinë;
- Përmirësimi i performancës së Ngrohjes Qendrore në Gjakovë.

Edhe në vitin 2023 janë paraparë një numër i aktiviteteve të cilat me realizimin e tyre do të ndikojnë në rritjen e Efiçiencës së Energjisë (EE). Numri i aktiviteteve të cilat janë realizuar në vitin 2023 janë ndër aktivitetet të cilat kanë ndikuar në rritjen e Efiçiencës së Energjisë (EE), duke konstatuar një realizim mesatar. Këto aktivitete janë:

- Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit të Ngrohjes Qendrore (NQ) në Prishtinë;
- Instalimi i pajisjeve matëse për konsumatorët e "Termokosit";
- Zbatimi i masave të Efiçiencës së Energjisë (EE) në ndërtesa publike ( në nivel komunal);
- Zbatimi i masave të Efiçiencës së Energjisë (EE) në sektorin rezidencial.

## Objektivi 4: Forcimi i Bashkëpunimit Rajonal dhe Funksionimit të Tregut

Republika e Kosovës, është e zotuar që të zbatojë të gjitha obligimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) për krijimin e një tregu energjetik të lirë, të integruar dhe konkurrues.

Në vitin 2022 është paraparë një aktivitet i cili është realizuar në masë të kënaqshme. Ky aktivitet ka të bëjë me:

- Bashkimi me tregun një ditë para me Shqipërinë përmes bursës së energjisë Alpex.

Aktivitetet të cilat janë paraparë të realizohen në vitin 2023, shumica janë rregullimi i infrastrukturës ligjore në funksion të heqjes së barrierave për funksionimin e tregut, si dhe aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me bashkimin e tregut me Shqipërinë. Numri i aktiviteteve të realizuara sa i përket legjislacionit janë ndër aktivitetet të cilat ndikojnë në heqjen e barrierave për funksionim të tregut duke konstatuar një realizim mesatar. Ndërsa sa i përket forcimit të bashkëpunimit rajonal duke konstatuar një realizim të kënaqshëm. Këto aktivitete janë:

- Bashkëpunimi me tregun një ditë para me Shqipërinë përmes bursës së energjisë Alpex;
- Draftligji për Energjinë;
- Draftligji për Energjinë Elektrike;
- Draftligji për Rregullatorin e Energjisë.

## Objektivi 5: Mbrojtja dhe Fuqizimi i Konsumatorëve

Strategjia e energjisë vendos njerëzit në qendër të saj dhe vendos objektivat në këto fusha, andaj për këtë qëllim janë paraparë disa aktivitetet në Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025.

Në vitin 2022 është i paraparë një aktivitet i cili ndikon në arritjen e objektivit në fjalë. Ky aktivitet është realizuar në mënyrë të kënaqshme.

- Mbështetja e konsumatorëve në nevojë përmes skemave ekzistuese të mbështetës;

Në vitin 2023 janë paraparë disa aktivitet për tu realizuar. Këto aktivitet për vitin 2023 konstatojmë se kanë pasur një realizim jo të kënaqshëm. Këto aktivitete janë:

- Mbështetja përmes subvencionimit të metodave alternative (dru dhe pelet) për qëllime ngrohje për grupet e cenueshme;
- Mbështetja e familjeve përmes subvencionimit të faturës se muajit aktual të energjisë elektrike, bazuar në përqindjen e kursimeve të energjisë që kanë bërë në krahasim me të njëjtin muaj të një viti më parë;
- Mbështetje përmes subvencionimit të një pjese të faturës për përfituesit e skemave sociale dhe pensionale, si dhe familjet që përzgjidhen përmes një skeme formale të testuar.

# 5 RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Gjatë monitorimit të zbatimit të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025, kemi hasur në disa rreziqe të cilat lidhen me kapacitetin institucional, kapacitetin financiar, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera, si dhe faktorë të tjerë të jashtëm që janë shfaqur gjatë realizimit të aktiviteteve, dhe që ndikojnë në zbatimin e dokumentit strategjik.

Në kuadër të monitorimit të Zbatimit të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës për periudhën 2022-2025, Ministria e Ekonomisë (ME), përkatësisht Departamenti i Energjisë (DE), ka koordinuar procesin e hartimit të Raportit të Progresit aktiviteteve të parapara. Ky monitorim është bërë duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse ku janë identifikuar rreziqet të cilat do të adresohen në vitet e ardhshme me masa konkrete. Ministria e Ekonomisë (ME), do të vazhdoj bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet relevante dhe ndërmarrjet kryesore të sektorit të energjisë në adresimin e të gjitha rreziqeve me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen.

Konstatimi i ngecjeve në realizimin e disa projekteve të parapara na drejton në marrjen e hapave të domosdoshëm, dhe konkret në eliminimin e barrierave që pengojnë në zhvillimin e sektorit të energjisë. Planifikimi i projekteve dhe aktiviteteve nga institucionet përgjegjëse për energji elektrike, është mjaft i rëndësishme në suksesin dhe zhvillimin e  sektorit të energjisë. Një rol të rëndësishëm luan edhe lehtësimi i procedurave burokratike me qëllim të mosvonesës dhe ngecjes së projekteve.

**<u>Sfidat dhe mangësitë:</u>**

Sfidat, mangësitë dhe pengesat e hasura gjatë monitorimit të këtij dokumenti lidhen me kapacitetin institucional, kapacitetin financiar, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera, si dhe faktorët e tjerë të jashtëm që ndikojnë në nivelin e zbatimit të dokumentit strategjik.

Gjatë realizimit të projekteve dhe aktiviteteve të parapara, institucionet përgjegjëse mund të këtë sfida, mangësi dhe pengesa varësisht nga natyra e projekteve. Disa nga sfidat të cilat janë identifikuar gjatë realizimit të disa projekteve dhe aktiviteteve janë: mosnënshkrimi i marrëveshjeve për financim të projekteve dhe ratifikimi i tyre në Kuvendin Republikës së Kosovës. Si sfida të tjera të paraqitura janë: vonesa në marrjen e lejeve nga institucionet përkatëse për ndërtim, shpronësimi i tokave dhe ngritja e çmimeve në treg, çmimet e vjetra të kontratave, vonesa në procese të prokurimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm**

Gjatë monitorimit të Raportit të Progresit, mund të konstatohet se është shënuar një progres i kënaqshëm, respektivisht në vitin 2022 është arritur realizmi i objektivave në një masë rreth shtatëdhjetë e tre përqind (73%), kurse në vitin 2023 ka pasur progres më të ulët rreth pesëdhjetë e një përqind (51%).

Një ndër arsyet e pengesave të realizimit të aktiviteteve janë: mosratifikimi i marrëveshjeve financiare, planifikimi jo i duhur i afateve kohore të implementimit të aktiviteteve. Një pengës tjetër që ka shkaktuar realizimin në kohë të aktiviteteve, është edhe ndërlidhja e tyre me dokumentet strategjike, programeve të cilat fillimisht është dashur të jenë të aprovuara dhe të jenë në fuqi. Si pengës tjetër janë edhe procedurat burokratike për marrjen e lejeve të ndryshme për realizimin e aktiviteteve të parapara, dhe procedurat e prokurimit. Mungesa e fuqisë punëtore të profileve specifike për shkak të mungesës së programeve arsimore.

**Rekomandimet:**

Për hapat e ardhshëm duke u bazuar në konkluzionet dhe të gjeturat nga raportimi i institucioneve mbi zbatimin e aktiviteteve dhe masave në kuadër të objektivave strategjike janë:

- Planifikim më i mirë i afateve kohore për miratimin e kornizës ligjore;
- Lehtësimi i procedurave për marrjen e lejeve me qëllim që mos të ketë vonesa në fillimin e realizimit të projekteve;
- Shpronësimi me kohë i pronave aty ku parashihet të realizohen projektet;
- Planifikimi me i saktë i aktiviteteve dhe afateve kohore të implementimit të projekteve nga institucionet duke marrë për bazë pengesat dhe sfidat që mund t’i kenë gjatë realizimit të projekteve;
- Nënshkrimi dhe ratifikimi me kohë i marrëveshjeve financiare nga institucionet përgjegjëse;
- Të rishikohen kurikulat në nivelin e arsimit të mesëm, dhe të lartë që t’ju përshtaten profileve specifike të kërkesave për punë.

# 6 SHTOJCA- MATRICA E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITET 2022-2023

***MBIKQYRJA E ZBATIMIT TË PZSE 2022-2025: OBJEKTIVI STRATEGJIK 1***

**SO1: PËRMIRËSIMI I BESUESHMËRISË SË SISTEMIT**

| **Nr.** | **Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet** | **Vlera bazë** | **Objektivi i vitit të fundit 2031** | **Rezultati** |
|---|---|---|---|---|
| **I.** | **OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PËRMIRËSIMI I BESUESHMËRISË SË SISTEMIT** | | | |
| 1 | Indikatori: Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjes së sistemit (SAIDI) | SAIDI: 80.83 orë/vit (2021) | SAIDI: 51.84 orë/vit | |
| 2 | Indikatori: Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve të sistemit (SAIFI) | SAIFI: 58.27 (2021) | SAIFI: 40.86 | |
| **I.1** | **Objektivi specifik: Rritja e fleksibilitetit të sistemit** | | | |
| | **Indikatori** | **Vlera bazë** | **Objektivi i vitit të fundit 2031** | |
| 1 | Niveli i kapacitetit rregullues fleksibil | 5 MW (2022) | 170 MW | |

| **Nr.** | **Veprimi** | **Afati i fundit** | **Buxheti** | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti** | **Referenca në dokumente** | **Progresi në zbatim 2022** | **Progresi në zbatim 2023** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Viti** 2022 | **Viti** **2023** | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.1.1 | Përgatitja e parafizibilitetit, fizibilitetit dhe projekteve teknike për sistemin e ruajtjes së baterive | 2025 | € - | **$ 1,180,837.00** | Donatorë | MCC, ME KOSTT | Dokumentacioni teknik i përgatitur | Strategjia e Energjisë 2022-2031 | | **Institucioni pergjegjes ka raportuar se ky aktivitet nuk peshohet me përqindje** Konsulenti për Dizajn dhe Mbikqyrje për sistemin e ruajtjes se energjise me bateri (BESS) është kontraktuar dhe ka filluar punen në nëntor 2023. Aktualisht ka filluar puna për dizajnin bazë të BESS duke përfshirë sistemin e baterive dhe kycjen në rrjetin e transmisionit, si dhe pergaditjen e pakos tenderuese per ndertimin e BESS |
| I.1.2 | Mbështetje teknike dhe ligjiore për integrimin e baterive - Projekti i MCC | 2025 | € - | **$ 1,916,000.00** | Donatorët | MCC, ME KOSTT | Dokumentacioni teknik i përgatitur | Strategjia e Energjisë 2022-2031 | | **Institucioni përgjegjes ka raportuar se ky aktivitet nuk peshohet me perqindje** Konsulent Mbështetës për sistemin e ruajtjes së energjisë me bateri (BESS) janë kontraktuar në maj të 2023 të cilet janë angazhuar në hartimin dhe plotesimin e kornizes ligjore për të mundesuar kycjen e baterive në rrjet si dhe analizen e |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | opsioneve për pronesinë e baterive për KOSTT. Këta dy konsulente kanë dhënë mbështetje të përgjithshme për përgatitjen e dokumentacionit për krijimin e ndërmarrjes së re publike MFES me vendim te Qeverise si dhe mbeshtetje per plotesimin e kushteve pararendese. Sa i perket funksionalizimit te ndermarrjes, eshte miratuar perfshirja e konsulentit per asistence teknike ne plan te prokurimit te MCA-Kosove, e cila do te mbeshtes ndermarrjen ne hartimin e planit te biznesit, rregulloreve teknike per operim te baterive, politikave te qeverisjes korporative dhe financiare, etj. |
| I.1.3 | Master Plani i Zhvillimit të Gazit dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (VNM) | 2023 | € 750,000.00 | **€ 750,000.00** | WBIF / IPF9 | ME, MMPHI, MINT | Masterplani i Gazit dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor i Finalizuar | Strategjia e Energjisë 2022-2031 | **0%** Arsyeja e mos realizmit të aktivitetit në vitin 2022 është sepse kanë qenë ende të padefinuara politikat për gazin meqenëse Strategjia e Energjisë ishte ende në proces të hartimit. | **100%** Master Plani i zhvillimit të gazit në Kosvë ka përfunduar dhe me datë 07.11.2023 është pranuar pëlqimi nga MMPHI lidhur me raportin per Vlerësimin Strategjik Mjedisor. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.1.4 | Studimi i fizibilitetit për Gazsjellësin e Interkoneksionit të Maqedonisë Veriore – Kosovë | 2023 | € 325,000.00 | **€ 325,000.00** | WBIF/IPF 9 | ME, MMPHI, MINT | Studimi i fizibilitetit i finalizuar | Strategjia e Energjisë 2022-2031 | **0%** Arsyeja e mos realizmit të aktivitetit në vitin 2022 është sepse kanë qenë ende të padefinuara politikat për gazin meqenëse Strategjia e Energjisë ishte ende në proces të hartimit. | **100%** Ky studim ka përfunduar dhe si I tillë është raportuar në TM2 2023 |
| I.1.5 | Studim për identifikimin e potencialit të energjisë gjeotermale në Kosovë | 2025 | | | Donatorët | ME | Studimi i fizibilitetit i realizuar | Strategjia e Energjisë 2022-2031 | | |
| **I.2** | **Objektivi specifik: Modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve në rrjet** | | | | | | | | | |
| | **Indikatori** | **Vlera bazë** | | | **Objektivi i vitit të fundit 2031** | | | | | |
| 1 | Humbjet në shpërndarje | 18.48% [2021] | | | 9% | | | | | |
| 2 | Sasia e kapacitetit variabil të BRE-ve që rrjeti është në gjendje të tajtojë/integrojë | 147 MW [2021] | | | 2000 MW | | | | | |
| **Nr.** | **Veprimi** | **Afati i fundit** | **Buxheti** Viti 2022 | **Buxheti** Viti **2023** | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti** | **Referenca në dokumente** | **Progresi në zbatim 2022** | **Progresi në zbatim 2023** |
| I.2.1 | Zhvillimi i sistemit (SCADA & Telekomunikacion) | Vjetore | € - | **€ 5,684,923.33** | KOSTT | KOSTT | Kërkesat e ENTSO-E janë plotësuar | Strategjia e Energjisë 2022-2031 | | **0%** Projekti ka vonesa dhe nuk ka filluar me realizim shtyhet, për shkak të voneses së ratifikimit të marreveshjes me KFW. Realizimi financiar 0€. Projekti është bartë në grupin |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | e projekteve për financim me KfW faza e VII. |
| I.2. 2 | Përforcimi dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues të energjisë (OST) | Vjetore | € 2,400,000.00 | **€ 2,260,000.00** | KOSTT | KOSTT | Rritja e besueshmërisë dhe sigurisë së rrjetit | Strategjia e Energjisë 2022-2031 | **0%** Projekti është pjesë e paket projekteve të planifikuara me investim përmes kredisë KfW faza e VII .Për shkakë të vonesave në nëshkrim dhe ratifikim të Marrëveshjes realizimi planifikohet të jetë në periudhën prej vitit 2024- 2027. | **0%** Projekti ka vonesa dhe nuk ka filluar me realizim shtyhet, për shkak të voneses së ratifikimit të marreveshjes me KFW. Realizimi financiar 0€. Projekti është bartë në grupin e projekteve për financim me KfW faza e VII. |
| I.2. 3 | Ndërtimi i kapaciteteve të reja të transmetimit dhe kapaciteteve transformuese - Reaktori shunt-variabël (100 MWAr) | 2025 | € - | **€ 1,000,000.00** | KOSTT | KOSTT | Rritja e besueshmërisë dhe sigurisë së rrjetit. Plotësimi i kërkesave të Kodit të Rrjetit | Strategjia e Energjisë 2022-2031 | | **0%** Projekti ka vonesa dhe nuk ka filluar me realizim shtyhet, për shkak të voneses së ratifikimit të marrevesjes me KFW. Realizimi financiar 0€. Projekti është bartë në grupin e projekteve për financim me KfW faza e VII. |
| I.2. 4 | Mbështetja e ngarkesës/ Nyjet e reja 110/10 (20) kV (OST & OSSH) (SS Katrioti Ferizaj 3 dhe TS Malisheva"(SS Katrioti Ferizaj 3 and TS Malisheva | Vjetore | € 3,000,000.00 | **€ 5,061,277.00** | KOSTT | KOSTT | Reduktimi i humbjeve të energjisë dhe fuqisë së pashërbyer | Strategjia e Energjisë 2022-2031 | **37.50%** 1. Ndërtimi I NS 110/35/10(20)kV Ferizaj 3 deri në fund të vitit 20222 kanë përfunduar 60% e punëve , por problemet rreth shpronësimit dhe servitutes me | **57.50%** 1. Projekti ,NS Ferizaj 3 - Kastriot ka perfunduar Qershor të vitit 2023 , me kohë dhe sipas buxhetit por nuk është energjizuar( 40%). Energjizimi i nënstacionit është i |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | pronarë të tokave në rajonin e Ferizajit kanë ndikim në vonesën e ndërtimit të Projektit të linjës 110KV e kjo ka ndikim n= Energjizim të Nënstacionit. Projekti Pritet të përfundoj në TM2 2024.<br>2. Ndërtimi i NS Fushë Kosova është nënshkruar kontrata në fillim të vitit 2022, dhe gjatë këtij viti janë angazhimet në përgaditjen e dokumentacionit për marrjen e lejës së ndërtimit. Projekti gjatë vitit 2022 është realizuar 15%, që është mbrenda kohës dhe buxhetit Pritet të përfundoj në vitin 2024.<br>3. Projekti i NS Malishevëz është në fazën e përgaditjes së dokumentacionit ndërtimor konform Ligjeve , për tenderim pritet gjatë vitit 2024 | ndërlidhur me Projektin "Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Ferizaj 3 - Kastrioti", e procesi i ndërtimit të linjës është vonuar, për shkak të pezullimit nga MMPHI, si rezultat i disa ankesave në gjykatë nga pronarët e tokave.<br>2. Projekti "Ndërtimi i NS Fushë Kosova " pas marrjes së lejeve për ndërtimi gjatë vitit 2023 ka vazhduar me ndërtim dhe instalim .Gjatë vitit 2023 janë përfunduar 75% e punëve që në Total është 90% e punëve . Projekti pritet të cili përfundoj gjatë vitit 2024 sipas kohës dhe buxhetit. Konform Ligjit për projektin NS Malisheva ëshrtë duke u përgaditur dokumentacioni - dizajni për aplikim pë marrjen e e lejevetë ndërtimit. Buxheti i shpenzuar për vitin 2023 është 3,934,964.56€ |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.2. 5 | Projektet e Tensionit të<br>Mesëm 35/10(20) kV | Vjetore | € 9,247,735.33 | **€ 13,216,444.00** | KEDS | KEDS | Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike | Strategjia e Energjisë 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | **196%, sqarim: vlera e projektit e prezantuar në vitin 2022 është vlera e reaizuar por planikifimi ka qenvn më i ulet** Janë realizuar 9,247,735.33 € investime në rrjetin e tensionit të mesëm, ku përfshihen projektet për Përforcim të rrjetit dhe Shndërrim të rrjetit nga 10 kV në 20 kV. Nga këto projekte do të arrihet: Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike, siguria e furnizimit, reduktimi i humbjeve në rrjet të shpërndarjes, rehabilitimi dhe modernizimi i rrjetit ekzistues etj. | **86%** Janë realizuar 11,326,311.65 € investime në rrjetin e tensionit të mesëm, ku përfshihen projektet për Përforcim të rrjetit dhe Shndërrim të rrjetit nga 10 kV në 20 kV. Nga këto projekte do të arrihet: Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike, siguria e furnizimit, reduktimi i humbjeve në rrjet të shpërndarjes, rehabilitimi dhe modernizimi i rrjetit ekzistues etj. |
| I.2. 6 | Projektet e Tensionit të<br>Vogël 0.4 kV | Vjetore | € 6,086,381.41 | **€ 7,025,149.00** | KEDS | KEDS | Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike | Strategjia e Energjisë 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | **66%, sqarim: vlera e projektit e prezantuar në vitin 2022 është vlera e reaizuar por planikifimi ka qenen me i lartë** Janë realizuar 6,086,381.41 € investime në rrjetin e tensionit të ulët, ku përfshihen projektet për Përforcim dhe Zgjerim të rrjetit. Nga këto projekte do | **125%** Janë realizuar 8,746,941.75 € investime në rrjetin e tensionit të ulët, ku përfshihen projektet për Përforcim dhe Zgjerim të rrjetit. Nga këto projekte do të arrihet: Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike, siguria e furnizimit, çasje më e lehtë në |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | të arrihet: Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike, siguria e furnizimit, çasje më e lehtë në pikën matëse, reduktimi i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes etj. | pikën matëse, reduktimi i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes etj. |
| I.2.7 | Rrjeti i zgjuar (Smart Grid) | Vjetore | € 14,513.93 | **€ 2,413,843.29** | KEDS | KEDS | Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike | Strategjia e Energjisë 2022-2031Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | **2%, sqarim: vlera e projektit e prezantuar në vitin 2022 është vlera e reaizuar por planikifimi ka qenën më i lartë** Janë realizuar 14,513.93 € investime në rrjet të zgjuar. Nga këto projekte do të arrihet: Monitorimi dhe kontrolli i të gjithë rrjetit në kohë reale, rritja e cilësisë së furnizimit, informata për rrjetin në kohë reale, reagim i shpejtë ndaj prishjeve, etj. | **13%** Janë realizuar 319,420.90 € investime në rrjet të zgjuar. Nga këto projekte do të arrihet: Monitorimi dhe kontrolli i të gjithë rrjetit në kohë reale, rritja e cilësisë së furnizimit, informata për rrjetin në kohë reale, reagim i shpejtë ndaj prishjeve, etj. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.2.8 | Instalimi i njehësorëve | Vjetore | € 1,612,032.60 | **€ 4,000,015.00** | KEDS | KEDS | Reduktimi i humbjeve komerciale. Për periudhën 2022-2025 parashikohet të instalohen rreth 121,782 njehsorë të rinjë - lidhjet e reja , ndërsa parashikohet të ndërrohen rreth 86,578 njehsorë. | Strategjia e Energjisë 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | **137%, sqarim: vlera e projektit e prezantuar në vitin 2022 është vlera e reaizuar por planikifimi ka qenën më i ulet** Janë realizuar 1,612,032.6 € në instalim të njehsorëve, ku janë ndërruar 20,013 njehsorë dhe janë instaluar 25,782 njehsorë të rinj - lidhjet e reja. Nga këto projekte do të arrihet: Saktësi në matje, matje në distancë, faturim dhe lexim i saktë dhe i shpejtë, reduktim i humbjeve komerciale etj. | **112%** Janë realizuar 4,473,568.6 € në instalim të njehsorëve, ku janë ndërruar - 27,901 njehsorë dhe janë instaluar - 24,750 njehsorë të rinj - lidhjet e reja. Nga këto projekte do të arrihet: Saktësi në matje, matje në distancë, faturim dhe lexim i saktë dhe i shpejtë, reduktim i humbjeve komerciale etj. |
